



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 19.04.2022, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
4. Shahadije Bikilqi Dragaçina, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Idajet Garip, anëtar
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Zoran Cirkovic, anëtar
9. Ana Guciq, anëtare

Të tjerë prezent

1. Rexhep Rexhepi drejtor i DBPZHR
2. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
3. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Fisnik Dida, OSBE
5. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete
2. Informatë nga drejtorati për bujqësi për subvencionet për bujqë
3. Raporti i ZKKK-së
4. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e parë e Komitetit për Komitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime në ekstraktin nga mbledhja e 2-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Pastaj u kalua në pikën e tretë të rendit të ditës.

III

Raporti i ZKKK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Zoran Stanojevic nga ZKKK-së, i cili në pika të shkurta i njoftoi rreth Raporti i punës së ZKKK-së-së, ku tha që vlen të veçohet një rast i një vizite në fshatin Grackë të një familje ku jeton aty një grua e vetme në kushte të mjerueshme dhe nësi zyre i kemi ndihmuar ti sa kemi pas mundësi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Zoran Cirković, tha se sa i përket rastit të familjes në Grackë i kemi njoftuar policinë po ashtu kanë qene dhe zyrtaret e ZKKK-së. Ne jemi munduar disa herë ta ndihmojmë por është shumë i komplikuar, pasi që edhe ndihmën nuk e ka pranuar, dhe si rast është ndër keq pse janë njoftuar policia. Unë i falënderoj të gjithë ata që kanë ndihmuar këtë familje dhe janë të gatshëm të ndihmojnë.

Ana Guciq, tha se a ka dikë nga familja kjo grua. Dhe a kishim mujt dikush nga ana jon me i ndihmuar ose me rregulluar diçka.

Zoran Cirković, tha se ai ka familjar ma të largët por ajo nuk e pranon ndihmën e askujt.

Lumturije Bytyqi-Hasani, se sa i përket kësaj zyre kjo ka një punë të rëndësishme por unë e kam një propozim që të ju epet me shume rëndësi shkollimit të komunitetëve në veçanti të ai rom dhe ashkali, pasi që po e braktisin mësimin dhe do të ishte mirë që të ju ndihmohej me bursa të paktën 50 nxënësve.

Zoran Stanojevic, tha se sa i përket bursave kjo është çështje e DKA-së, ndërsa në mund të ndihmojmë vetëm ndonjë rast të sëmundjes, apo ndonjë rast me kushte jo të mira.

Gentianë Hoxhaj, është mirë që kemi raporte të tilla por nuk besoj që do të ishte mirë të flasim me emra se cilat raste janë ndihmuar, apo përkrahur. Kam një pyetje edhe unë si është gjendja e shkollimit të komunitetave.

Pastaj u kalua në pikën e dytë..

II

Informatë nga drejtorati për bujqësi për subvencionet për bujq

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Rexhep Rexhepit, nga DB -së, i cili në pika të shkurta i njoftoi rreth subvencioneve për bujq.

Zoran Cirković, tha se e falënderoj drejtorin për informatën, në kemi pas bashkëpunim me drejtorin e me hershëm shpresojmë të vazhdojmë në bashkëpunim edhe me juve. Kur pritet të fillojë ndarja e subvencioneve për bujq.

Shahadije Biliqi, tha se si do të ishte mundësia nga komuna që të ketë qasje me të lehtë për informim qytetarët e komunës së Lipjanit rreth subvencioneve.

Rexhep Rexhepi, tha se informimi bëhet përmes faqes zyrtare të komunës aty publikohet njoftimi për subvencione.

Lulmturie Bytyqi-Hasani, tha se do të ishte mirë që kur të ndahen subvencionet komunitetet të stimulohen pak me shumë, në kushte të barabarta do të ishte mirë që përparësi të ju epej komuniteteve.

Gentianë Hoxhaj, tha se nuk e di se si kanë vepruar me herët të ndarja e subvencioneve por do të ishte mirë që të stimulohen komunitetet.

Zoran Cirković, tha se i falënderoj 3 koleget të cilat janë edhe anëtare të kuvendit, e në veçanti për përkrahjen e komuniteteve jo shumicë në komunën tonë. Do të ishte mirë që në kushte të barabarta komunitetet të jenë të stimuluar.

Pastaj u kalua në pikë në vazhdim.

IV

Të ndryshme

Skender Bikliqi, tha se në shumë shpejtë do të kemi një takim me anëtarët e Komitetit me OSBE-në, për miratimin e planit të punës së komitetit për komunitete.

Zoran Cirković, tha se kam një kërkesë që të bëhet pastrimi i varrezave në fshatin Grackë e vjetër.

Skender Bikliqi, tha se duhet me bisedua me dike nga drejtorati i infrastrukturës, lidhur me këtë çështje.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14¹⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi